

AKTI I THEMELIMIT  
SHOQËRIA BENALT SHPK

**NENI 1 - Ortakët Themelues sot me date :**

**1.1** Shoqëria BENALT SHPK themelohet nga Ortakët:

Z. Altin Dërmyshi, I biri i Aqifit shtetas shqiptar, lindur me 09.10.1972, dhe banues në Kavajë, mbajtes i Nr. Personal H21009063H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Z. Arben Snalla i biri i Isufit shtetas shqiptar, lindur më 10.03.1971, dhe banues në Elbasan, mbajtës i Nr. Personal H10310026O, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar;

Sot me date **20.01.2022**, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, vendosën te themelojnë shoqërine tregtare Si vijon.

**NENI 2 Emërtimi, Objekti**

**2.1-** Emertimi i shoqërisë është " BENALT" SHPK (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**2.2-** Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Grumbullim dhe tregëti skrapesh të ndryshme (metale me ngjyra) Shërbime të ndryshme për të tretët.

**2.3 -** Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër i cili është në përputhje me Ligjet e Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3 – Forma Ligjore, Selia**

**3.1-** Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri. nr. 9901, datë 14.04.2008. "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Ttregtare", i ndryshuar.

**3.2-** Shoqëria do të ketë qendrën e veprimtarisë së saj në qytetin e Kavajës me certificate pronësie nr 1456523, nr pasurie are 18/489 zona kadastrale nr 8552 volumi 18 faqe 197. Shoqëria ka të drejtë që me vendimin të asamblesë së ortakëve mund të hapë qendra sekondare dega ,zyra filjale ose përfaqësi të shoqërisë në qytete të tjera të Shqipërisë.

**NENI 4 - Personsliteti Juridik Kohë zgjatja**

**4.1-** Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në Kavajë, Shqipëri. Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit në fuqi në Shqipëri

Në këtë rast Ortakët do të përshtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, si dhe do të bëjnë regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar në organet kompetente shqiptare.

**4.2-** Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar. Me vullnetin e asamblesë së ortakëve ,kjo shoqëri mund të mbyllet edhe para afatit ,në rastet kur kjo shoqëri humbet efektivitetin ekonomik për ortakët.

#### **NENI 5 - . Vula**

**5.1** -Shoqëria do të ketë emblemën, dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë për dokumentacion.

**5.2** - Forma dhe përmasat e vules do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar

**5.3** -Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë vulën e saj .

#### **NENI 6 - Të drejtat e Shoqërisë dhe të Ortakëve**

**6.1.**Shoqëria ka të drejtë të lidhë marreveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj .

**6.2.** Shoqëria gëzon të drejtën të krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

**6.3.** Shoqëria ka të drejtë të marrë pjesë si ortakë në shoqëri ose ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri ose jashtë saj, në përputhje me legjislacionin Shqiptar.


**6.4.**Shoqëria përgjigjet ndaj të tretëve vetëm dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqëror të derdhur dhe me të mirat e pasurisë së saj.

**6.5.**Ortakë kanë të drejtë të marrë të gjitha informatat që kanë të bëjnë me veprimtarinë prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare të Shoqërisë, si bilanci, llogaritë ekonomike, etj

**6.6.**Ortakë kanë të drejtë të bëjnë propozime, si dhe emërojnë e shkarkojnë, administratorin ose administratorët, punonjësit, ekspertin kontabël, apo likuidatorët

#### **NENI 7— Kapitali Themeltar**

**7.1-** Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë .kontribut I ortakëve themelues



7.2- Kapitali themeltar përbëhet nga 2 (dy) kuota.

7.3- Pjesët e kapitalit themeltar zotërohen nga ortakët në masën si më poshtë:

Z. Altin Dërmyshi zotëron 1 (një) kuota me vlerë nominale 50,000 (pesëdhjetëmije) Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Z. Arben Snalla zotëron 1 (një) kuota me vlerë nominale 50,000 (pesëdhjetëmije) Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

7.4 -Kapitali është shlyer tërësisht.

7.5 -Përgjegjësia e Ortakëve shtrihet deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e Shoqërisë

7.6 -Asambleja e ortakëve ka të drejtë të bëjë shtesë të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **NENI 8 – Të Ardhurat , Dividenti**

8.1- Shoqëria mund të krijojë fonde rezerve për realizimin e qëllimeve të aktivitetit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901. datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

8.2- Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen nga Asambleja e Ortakëve. 50 % Altin Dërmyshi me 50 % Arben Snalla

8.3- Humbjet e shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo ortak do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë

#### **NENI 9 - Struktura Juridike dhe Administrimi i Shoqërisë**

Organet e shoqërisë janë :

9.1 -Asambleja e ortakëve

9.2- Ortakët e shoqërisë 1-z Altin Dërmyshi dhe 2- Arben Snalla

9.3- Kohëzgjatja në detyrë e administratorëve të shoqërisë do të jetë 5 ( pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje në përfundim të mandatit

#### **NENI 10- Dispozitat e Fundit**

10.1- Ndryshimet në këtë Akt-Themelimi mund të bëhen vetëm me shtesë me shkrim dhe të miratuar nga asambleja e ortakëve

10.2 -Ky akt-themelimi u hartua në 4 (katër) kopje origjinale me fuqi të njëjtë ligjore I cili nënshkruhet konform ligjit.

#### **ORTAKËT**

**Altin Dërmyshi**

**Arben Snalla**